



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2022:130102

Datë: 26.09.2022

Numri i dokumentit: 03459405

**P.nr.101/22**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË–DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit H. B. nga fshati Pataqan i Epërm, komuna Rahovec, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.905/2022 të datës 23.06.2022, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, me datë 26 Shtator 2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e lidhur në mes të të pandehurit H. B. nga fshati Pataqan i Epërm, komuna Rahoveci dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjakovë, A. B. në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjakovë-Dega në Rahovec, Nd.nr.31/2022 e datës 21.09.2022.

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.905/2022 të datës 23.06.2022 dhe **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit H. B. i lindur më datë ... në fshatin Pataqan i Epërm, komuna Rahovec, nga i ati A. dhe e ëma S., e gjinisë M., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

**III.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore e Gjakovës – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën, PP/II.nr.905/2022 të datës 23.06.2022, kundër të pandehurit H. B. nga Rahoveci, i akuzuar për veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar lidhur me këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, me datë 21.09.2022, me ç’rast i pandehuri H. B., pas shpjegimit të mundësisë së pranimit të fajësisë dhe mos pranimit të fajësisë për veprën penale për të cilën ngarkohet, ka deklaruar se para se të deklarohet lidhur me përgjegjësin penale pas njoftimit nga gjykata se mund të kaloj në procedurë të ndërmjetësimit, i ka propozoj gjykatës në qoftë se pajtohen Prokurori i shtetit dhe pala e dëmtuar që këtë çështje ta zgjidhin me pajtim-ndërmjetësim.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pasi mori edhe mendimin e Prokurorit së Shtetit Sadri Aliaj dhe përfaqësueses së autorizuar të të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjakovë, A. B., ka pranuar propozimin e të pandehurit H. B., me ç’rast e ka ndërprerë seancën e shqyrtimit fillestar, e më pas lëndën e ka dërguar në Zyrën Regjionale të Ndërmjetësimit.

Qendra e Ndërmjetësimit në Gjakovë-Dega në Rahovec, me vendimin Nd.nr.31/2022 të datës 21.09.2022, e ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar në mes të të pandehurit H. B. dhe të përfaqësueses së autorizuar të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjakovë, A. B., si vijon:

-Me datë 16.06.2022, në orën 10:30 minuta, në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, u mbajt seanca e ndërmjetësimit në mes të palëve: H. B. dhe përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjakovë, A. B., për rastin i cili ka të bëjë me veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

-Pala “B” (H. B.), ka deklaruar se i vije keq për rastin i cili ka ndodhur, mirëpo nuk ishte në dijeni për dëmin që ia ka shkaktuar të dëmtuarës KEDS, por në të njëjtën kohe ka shtuar se është i gatshëm që ti përgjigjet palës se dëmtuar, në këtë rast KEDS-it për rikthimin e humbjeve, por nga të njëjtit ka kërkuar që këtë rikthim të humbjeve t’ia mundësojnë ta paguajë me sa më shumë këste, pasi që i ka kushte të vështira materiale dhe është i papunë.

-Pala “A” (KEDS-Distrikti në Gjakovë), me autorizim në lëndë-A. B., ka deklaruar se palës “B” (H. B.), me DGJ9038219 ia mundëson që në emër të rikthimit të humbjeve, pagesa në shumë prej 849.79 €, t’i mundësohet që të bëhet me anë të gjashtë (6) kësteve dhe atë:

- 141.64 €, kësti i parë i cili duhet të paguhet me data 25.10.2022;
- 141.63 €, kësti i dytë duhet të paguhet me datë 25.11.2022;
- 141.63 €, kësti i tretë duhet të paguhet me datë 25.12.2022;
- 141.63 €, kësti i katërt duhet të paguhet me datë 25.01.2023;
- 141.63 €, kësti i pestë duhet të paguhet me datë 25.02.2023;
- 141.63 €, kësti i gjashtë duhet të paguhet me datë 25.03.2023.

-Pala “A” ka deklaruar se po e nënshkruan këtë marrëveshje pasi që pala “B” po premtonte se do t’i kryejë obligimet e marra për rikthimin e humbjeve ndaj KEDS-it, si dhe ka hequr dorë nga ndjekja e mëturjes penale ndaj palës “B” (H. B.).

-Palëve u është bërë e ditur se kjo marrëveshje e nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi, përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes dhe ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket tarifës së ndërmjetësimit, në shumë prej dyzetë (40) €, këtë e mori përsipër pala "B" (H. B.), i cili ka shtuar se këtë tarifë do ta paguajë atë ditë, pra me datë 21.09.2022.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në kuptim të nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 358 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së dhe nenit 15, par. 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

**- Divizioni Penal -**

**P.nr.101/22, datë 26 Shtator 2022**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Dardan Hoxha

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.  
**Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.**